



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 96, Datë 20.05.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“AYEN AS ENERGJI” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.05.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1053/1 prot., datë 16.05.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1053 prot., datë 08.05.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Kjo shoqëri ka një licencë të vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, deri më 24.09.2024. Duke qenë se shoqëria nuk aplikoi brenda datës 24.03.2024 për rinovimin e licencës, referuar nenit 16, pikës 1, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, ku përcaktohet se: *paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo me vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë*. Subjekti ka bërë aplikim të ri e si e tillë afatet e licencës në rast miratimi do të fillojnë nga data 25.09.2024.
- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar, e cila do të rakordohet në vijim me statement-in përkatës.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërma “a”; si dhe pikën 2.5.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi konstatohet se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”:** Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për shoqërinë dhe administratorin e saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”:** Aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacion vërtetues për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj.
- **gërma “c”:** Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE në kuadër të këtij aplikimi një plan biznesi për të gjithë periudhën e licencimit, jo vetëm për vitet e referuara sa më lart dhe gjithashtu ky plan biznesi nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në kontratat e bëra me dije por të jetë në formën e kërkuar i cili duhet të përmbajë: përcaktime në lidhje me parashikimin vjetor të kostove, shitjeve, të ardhurave dhe financimin e projektit/ushtimit të veprimtarisë për të cilën po kërkon të licencohet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI